**URDHËR**
**Nr. 48, datë 7.4.2023**

# PËR MIRATIMIN E DISTANCAVE KILOMETRIKE NDËRMJET QYTETEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE HARTËS SË PËRDITËSUAR TË RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 13.10.2021, "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Miratimin e "Hartës të Rrjetit Rrugor Kombëtar" të përditësuar, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Instituti i Transportit të bëjnë vazhdimisht përditësimin e tabelës së distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë dhe të hartës së Rrjetit Rrugor Kombëtar, sa herë të ketë ndryshime në segmentet rrugore të Rrjetit Rrugor Kombëtar.
4. Urdhri nr. 125, datë 26.12.2011, i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, "Për miratimin e hartave të azhurnuara të rrjetit rrugor kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë", shfuqizohet.
5. Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Instituti i Transportit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**Belinda Balluku**

# HARTA RRJETIT RRUGOR KOMBETAR



